

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK, TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në UPT, me objekt “Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik dhe financiar” për periudhën 01.01.2011-30.9.2013 si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së, nr. 850/6, datë 30.04.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 850/7, datë 30.04.2013 Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar Akademik Jorgaq Kaçani, Rektor i UPT.

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI:

Nga auditimi mbi zbatimin e *dispozitave ligjore për pagat e punonjësve* të personelit akademik të brendshëm dhe të jashtëm (me kontratë të përkohshme pune) në referencë të Udhëzimit të ish Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave, nr. 20, datë 9.5.2008 “Për veprimtarinë e Personelit Akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë” i ndryshuar, neni 20 dhe 21 u konstatua se:

Pagesa e pedagogëve që japin mësim në ciklin e tretë “doktoraturë”, është bërë pa u marrë më parë miratimi i ish MASH-it, kjo në kundërshtim me Udhëzimin e ish MASH-it nr. 20, datë 9.5.2008 “Për veprimtarinë e Personelit Akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë” i ndryshuar, neni 20. Nga kërkesat e kësaj dispozite shprehet qartë se “*Personeli akademik me kohë të plotë në ILA publike, mund të tejkalojë normën vjetore për mësimdhënie deri në masën 30% pasi të ketë plotësuar të gjitha detyrimet e kohës vjetore të punës*” dhe sipas pikës 21 “*Për personelin akademik të ftuar në njësitë kryesore të ILA publike mësimdhënia e normuar duhet të jetë deri në 150 orë mësimi në vit*”.

Nisur nga kjo problematikë e dalë nga auditimi, rezultoi se janë paguar pedagogët e brendshëm që japin mësim në ciklin e tretë të doktoraturës pa u marrë miratimi nga ish MASH në këto njësi varësie:

1. Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike në vlerën 1,743,966 lekë.
2. Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit në vlerën 632,880 lekë.
3. Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave në vlerën 1,620,612 lekë.
4. Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në vlerën 923,625 lekë.

PËR SA MË SIPËR ËSHTË REKOMANDUAR QË:

Universiteti Politeknik i Tiranës në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve të iniciojë për përmirësimin ligjor të nenit 20 të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 20, datë 9.05.2008 “Për veprimtarinë e personelit akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, i ndryshuar:

-Lidhur me nivelin e mundshëm të tejkalimit të normës së mësimdhënies për stafet akademike dhe duke ruajtur masën 30% vetëm për stafet akademike me funksione drejtuese.

-Të shprehet qartë që ngarkesa mësimore përfshin edhe orët part time të cilat të jenë pjesë e kufirit të përcaktuar.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Të merren masa që të mos tejkalohet norma vjetore për mësimdhënie deri në masën 30% sipas Udhëzimit të MASH-it nr. 20, datë 9.5.2008 “Për veprimtarinë e Personelit Akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë” i ndryshuar, neni 20, deri në miratimin e përmirësimit ligjor të kërkuar nga KLSH në vendimin e sipërcituar.

Menjëherë

2. Këshilli i Administrimit të Universitetit Politeknik, Tiranë të bëjë ndryshimet e nevojshme në nenin 7 të vendimit nr. 4, datë 01.9.2011 të tij, duke përcaktuar qartë përbërjen e grupit të punës për kryerjen e shërbimit të opionencës dhe përfshirjen në të edhe të asaj pjese të stafit teknik i cili ka lidhje direkt në kryerjen e këtij shërbimi dhe mbi këtë bazë të përcaktojë ndarjen e të ardhurave të krijuara nga opionencat teknike.

Menjëherë

3. Të merren masa për formalizimin e të ardhurave të realizuara sipas kërkesave të Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e shtuar, nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit njësi varësie e UPT-së, ku rezultoi se për shërbimin e opionencës nuk janë zbatuar kërkesat e Ligjit nr.7928 date 27.04.1995 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” me arsyetimin se shërbimi arsimor është i përjashtuar nga TVSH-ja dhe për pasojë skemës së TVSH-së i ka munguar vetëm për këtë periudhë të audituar shuma prej 6549,4 mijë lekë (32727 mijë lekë*20%).

Menjëherë

4. Plotësimin e menjëhershëm të dokumentacionit për studentët që përfitojnë nga përjashtimi i tarifës vjetore të shkollimit, sipas kërkesave të VKM-së nr. 420, datë 18.7.2002 “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, për vitin akademik 2012-2013”, me:

a- vërtetimin e lëshuar nga Komisioni i Shërbimit Social Shtetëror, sipas pikës 2 të VKM nr. 233, datë 10.4.1998 “Për statusin e jetimit” dhe nenit 1 të Ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit” për të gjithë studentët që gëzojnë statusin e jetimit,

b- vërtetimin e lëshuar nga Komisioni Trepalësh, që vërteton dhënien e statusit të të përndjekurit, në referim të nenit 15 të Ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist” me ndryshime, për të gjithë studentët që gëzojnë statusin e të përndjekurit politikë, trajtuar në fq 44-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

5. Të evidentohen në mënyrë të saktë transaksionet ekonomike që në momentin e konstatimit duke zbatuar me korrektësi parimet dhe standardet e kontabilitetit sidomos në mënyrën e njohjes dhe ndjekjes së aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe jo të trupëzuara. Të llogaritet me saktësi amortizimi dhe të merren masa për konsolidim të kujdesshëm të vlerave të paraqitura në bilancin e Universitetit Politeknik. (trajtuar në fq 44-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

6. Të merren masa për ngritjen e njësisë së auditimit të brendshëm, si strukturë më vete në përputhje me kërkesat e nenit 2 dhe 9 të Ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.

Menjëherë

7. Të merren masa për ngritjen e një grupi pune, për evidentimin e të gjitha rasteve për mos mbajtjen nga paga të kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve “akademik të ftuar” me kontratë në të gjitha institucionet e varësisë së UPT-së për vitin akademik 2013-2014, kontratat e të cilëve u audituan me zgjedhje sipas trajtimit të bërë në fq 26-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe (aneksi 6) si dhe kryerjen e pagesave për to konform legjislacionit në fuqi.

-Nga ana e Degës së Financës të bëhet kontrolli dhe llogaritja e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit akademik të ftuar në të gjitha institucionet e varësisë së UPT-së për vitin akademik 2012-2013 si dhe kryerjen e pagesave për to konform legjislacionit në fuqi. Praktikë që duhet të ndiqet edhe për vitin akademik 2013-2014 e vijim.

Menjëherë

8. Në mënyrë që të përmirësohet menaxhimi, institucioni i UPT-së të marrë masat për nxjerrjen e vendimeve të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin administrativ, financiar dhe ekonomik që lidhen me çdo vit buxhetor kjo ne zbatim të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”i ndryshuar, Kreu III, neni 16, prg.1 &2.

Rast pas rasti

9. Dega Ekonomike, të bëjë planifikimin e shpenzimeve operative mbi bazë nevojash dhe kërkesash sipas njësive shpenzuese mbështetur në ligjin për buxhetin.

-Për çdo vendim të Këshillit të Administrimit për shtesa dhe pakësim në buxhet të merret miratim nga MASH dhe Ministria e Financave, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9741 datë 21.05.2007“Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë“.

-Shtesat dhe pakësimet që bëhen gjatë vitit buxhetor të jenë bazuar në kërkesat e ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë“, neni45, pika a dhe b. Ndryshimet të pasqyrohen në regjistrin e parashikimeve publike në përputhje me VKM nr. 1, datë 10.10.1.2007 ”Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar kreu I, pika 3/b.

Menjëherë

10. Bazuar në VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” dhe VKM-së nr 870, datë 14.12.2011“Për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve dhe për dietat për punonjësit e ministrive dhe të institucioneve buxhetore, kur dalin jashtë shtetit”, të merret miratimi nga titullari i organit qendror (MASH) për likuidimin e shpenzimeve për dieta brenda vendit dhe jashtë vendit.

Menjëherë

11. Dokumentacioni i arkës të firmoset nga Nëpunësi Zbatues në përputhje me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” pika 68/a, b.

- Nëpunësi Autorizues të miratojë limitin ditor për arkën në kryerjen e veprimeve me para në dorë në përputhje me pikën 63, të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.

-Blerja e biletave të udhëtimit të bëhet sipas kriterëve të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 dhe udhëzimit të APP.

-Të gjitha praktikat për shpenzimet “Pritje përcjellje” të plotësohen me gjithë dokumentacionin justifikues sipas kërkesave të pikës 7 dhe 12 e VKM nr. 243 datë

15.5.1995 e ndryshuar për “Shpenzimet për pritje përcjellje dhe trajtimeve që u bëhet delegacioneve të huaja” si dhe ti nënshtrohen procedurave të prokurimit me blerje të vogël.

- Për materialet të evidentuara si materiale jashtë përdorimit duhet paraprakisht të bëhet vlerësimi i tyre nga komisioni i vlerësimit i ngritur nga titullari i institucionit sipas Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011.

-Të mbahet nga Nëpunësi Zbatues, regjistri përmbledhës kontabël për krijimin dhe përditësimin e aktiveve që zotëron apo ka në administrim UPT sipas Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, Kapitulli III, Pika 26,27,30, 31.

-Për materialet të evidentuara si materiale jashtë përdorimit duhet paraprakisht të bëhet vlerësimi i tyre nga komisioni i vlerësimit i ngritur nga titullari i institucionit sipas Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 pastaj të ndiqen hapat ligjorë për likuidimin e këtyre artikujve stok në magazinë.

-Të mbahet nga Nëpunësi Zbatues, regjistri përmbledhës kontabël për krijimin dhe përditësimin e aktiveve që zotëron apo ka në administrim UPT sipas Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, Kapitulli III, Pika 26,27,30, 31.

Menjëherë

12. Të merren masa që në procedurat e njëjta që do të realizohen, të ngrihet Komisioni i negocimit të ofertës, në përputhje me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, neni 33, i ndryshuar, procedura me “negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit” pika 5/a dhe VKM-në Nr.1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, kreu IV pika 5.

Menjëherë

13.Të gjitha studimet, projektet dhe preventivat që do të realizohen si objekte prokurimi, duhet të bëhen në përputhje me kushtet e projektimit dhe zbatimit. Vlera e objektit të llogaritet në zbatim të VKM-ve mbi “Manualin teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” sipas viteve përkatëse, pasi kjo shpreh saktë argumentimin e fondit limit.

Menjëherë

14.Të merren masa për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e lejeve zhvillimore e ligjshmërisë për të gjitha investimet që do të realizohen, qofshin ndërtime të reja apo rikonstrukcione të ndërtimeve ekzistuese.

Menjëherë

15.Nëpunësi Autorizues të marrë masa për të:

- hartuar dhe dorëzuar në afat “Deklaratën për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm” dhe “Pyetësin e vetëvlerësimit” në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

- hartuar regjistrin/strategjinë e risqeve në përputhje me nenin 21 të ligjit nr. 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, duke evidentuar risqet që pengojnë arritjen e objektivave të përcaktuara për këtë njësi publike, si dhe veprimet për minimizimin e tyre.

Menjëherë

16. Të merren masa për të rishikuar strukturën organizative në përputhje me VKM nr.474, datë 16.06.2011 “Për përcaktimin e standardeve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike”,

strukturën menaxheriale, për të reflektuar linjat e raportimit në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

-Të reflektohen të gjitha ndryshimet e duhura në rregulloren e brendshme të funksionimit të institucionit në lidhje me përgjegjshmërinë menaxheriale, kompetencat dhe përgjegjësitë e Nëpunësit Autorizues, Nëpunësit Zbatues dhe menaxherët e tjerë të Njesisë Publike.

Menjëherë

17. Zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së dërguar me shkresën nr. 478/5 datë 31.03.2011, trajtuar në fq. 8-9 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.Të kërkohet nga Universiteti Politeknik i Tiranës, në rrugë administrative bazuar në Kodin e Procedurave Administrative si dhe në rrugë ligjore bazuar në Kodin Civil, shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën **2,030,854** lekë gjithsej nga 13 persona sipas listës bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, të cilët kanë përfutur padrejtësisht në kundërshtim me nenin 7 të Vendimit të Këshillit të Administrimit nr. 4, datë 01.9.2011, pagesën për oponencë të kryer në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit.

Menjëherë

KONTROLI I LARTE I SHTETIT